



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2017

SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Varianti A

Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Profesionale, artistike, sportive, me kohë të shkurtuar

PJESA I

Orari i qarkullimit

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	C	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	B	1 pikë

Pyetja 8 2 pikë

➤ E veçoritë:

- fillon në vetën e parë njëjës,
- autori shtron tezën që në hyrje (për ta përfshirë veten dhe lexuesin apo dëgjuesin);
- përdor edhe një fjali pyetëse, që është edhe tema e kësaj pjese, si për ta ngacmuar diskutimin.

2 pikë Nëse identifikon dy veçori të paragrafit hyrës.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një veçori të paragrafit hyrës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (a) 3 pikë**➤ Teza**

- Duhet përforcuar orari i qarkullimit për adoleshentët.

➤ Argumentet:

- kanë nevojë për gjumë të mjaftueshëm;
- bien pre e krimit ose bëjnë vetë krime,
- mund të ndodhen në telashe.

1 pikë Nëse identifikon tezën e kësaj pjese.

DHE

2 pikë Nëse identifikon dy argumente në mbështetje të saj.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një argument në mbështetje të saj

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (b) 1 pikë

- **Dy këndvështrimet janë:** Zbatimi i një orari qarkullimi për të rinjtë dhe mos zbatimi i një orari të tillë. Nxënësi duhet të pozicionohet me njërin prej tyre dhe të japë një arsye për këtë zgjedhje.

1 pikë Nëse nxënësi pozicionohet me një nga këndvështrimet dhe shkruan një arsye për këtë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 2 pikë**➤ Masat:**

- policët duhet të ndalojnë të miturit që ndodhen jashtë;
- të japin paralajmërimë,
- ta shoqërojnë të miturin në shtëpi;
- prindërit ose kujdestarët e pavëmendshëm duhen gjobitur ose arrestuar.

2 pikë Nëse identifikon dy masa që autori propozon.

OSE

1 pikë Nëse identifikon vetëm një masë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11

2 pikë

Përgjigje e plotë

Nëse orari i qarkullimit për të rinjtë vendoset me ligj, atëherë kjo e lehtëson punën e prindërve. Tashmë ata e argumentojnë qëndrimin e tyre karshi fëmijëve bazuar edhe në ligj. Pra, adoleshentët nuk mund ta gjykojnë më vendimin e prindërve për të respektuar orarin si një tekë të këtyre të fundit, por edhe si respektimin e një detyrimi ligjor.

Përgjigje e pjesshme

Tashmë prindërit mbështeten edhe nga ligji dhe mund t'iu kërkojnë më lehtë llogari të rinjve.

2 pikë Nëse arsyetojnë ***në mënyrë të plotë*** mendimin.

OSE

1 pikë Nëse arsyetojnë ***në mënyrë të pjesshme*** mendimin.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 12

2 pikë

➤ **Përfundimi:**

- Vendosja e një orari i qarkullimit i mbron të miturit.

➤ **E veçanta**

- Është paragrafi përmbyllës. Autori shpreh mendimin e tij përfundimtar. Tonet janë sugjeruese.

1 pikë Nëse tregon përfundimin që arrin autori në paragrafin e fundit.

DHE

1 pikë Nëse tregon të veçantën e kësaj mbylljeje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

PJESA II

Kadare

Kronikë në gur

Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	C	1 pikë
Pyetja 17	A	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë

Pyetja 19 (a) 2 pikë

➤ **Arsyeja**

- pushtimi i qytetit nga gjermanët;
- bombardimi i qytetit nga pushtuesit;
- frika nga pushtuesit.

➤ **Përjetimi**

Ndihen të trishtuar, pa fjalë, pa gjumë, në ankth, të dërrmuar, konfuzë.

1 pikë Nëse tregon arsyen e largimit të banorëve nga qyteti.

DHE

1 pikë Nëse tregon si po e përjetojnë ata këtë largim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 (b) 2 pikë

- Për shkak të pushtimit dhe bombardimeve, qyteti mund të rrënohej përfundimisht.
- Parashikimi nuk del i saktë. Qyteti nuk rrënohet përfundimisht, pasi të nesërmen ai ishte sërish aty, pavarësisht se vende – vende ai ishte i shkatërruar.

1 pikë Nëse tregon se pse jo mund të ishte nata e fundit për qytetin.

DHE

1 pikë Nëse shpjegon pse ky parashikim nuk del i saktë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **2 pikë**➤ **Arsyet:**

- *lashtësia e këtij qyteti, që në kohën e Perandorisë Romake;*
- *jeta e vështirë që ai kishte pasur, përmes luftërave;*
- *pushtimet që e kishin shoqëruar përgjatë gjithë historisë;*
- *përsëritjen e historisë si një lloj fataliteti.*

2 pikë Nëse identifikon dy arsye për përmendjen e perandrive.

OSE

1 pikë Nëse identifikon një arsye për përmendjen e perandrive.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (a) **3 pikë****Analiza e plotë:**

- Qyteti vjen i personifikuar, duket si qenie e gjallë, që merr frymë, shfaq tipare njerëzore, ndien: mospërfillës, i ftohtë, i fyer. Në fakt janë cilësi të banorëve, që i mbart qyteti. Ai personifikohet apo metonimizohet, njëjtësohet me banorët e vet.
- Rrëfimi behët nga sytë e fëmijës, ndaj është mjaft emocionues, figurativ, tërheqës, ku mbizotëron fantazia, figurat.

Analiza e pjesshme

- Përshkrimi është emocionues dhe figurativ.

➤ **Figurat:**

Personifikime: *I lodhur, krejt i trullësuar nga ndeshja, ai s'jepte asnjë shenjë jete; ishte mospërfillës, i fyer pak nga braktisja.*

Metafora: *Guacka gjigante, gjysmë e braktisur, do të mbushej prapë pas disa orësh me hapa, pëshpërima, nerva, pasione, thashetheme, shpresa, dhëmbje njerëzore; i rëndonin mbi gjoks, një pjerrtësi mizore;*

Epitete: *mizore, e braktisur.*

2 pikë Nëse analizon ***në mënyrë të plotë*** të veçantën në mënyrën e të rrëfyerit.

OSE

1 pikë Nëse analizon ***në mënyrë të pjesshme*** të veçantën në mënyrën e të rrëfyerit.

DHE

1 pikë Nëse identifikon një figurë të stilistikës, bashkë me ilustrimin përkatës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b) 1 pikë

- Guacka gjigante nënkupton qytetin e braktisur, të lënë bosh për pak kohë dhe që do të mbushej pas disa orësh nga jeta, njerëzit dhe gjithçka ata sjellin me vete.

1 pikë Nëse zbërthen nëntekstin e fjalisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë➤ **Përshkrim real:**

- Ballë shtëpish të çara, ballkone të këputur, shenjat e goditjeve dukeshin kudo.

➤ **Përshkrim i poetizuar:**

- *I lodhur; krejt i trullosur nga ndeshja; ai s'jepte asnjë shenjë jete; kthetrat e hekurta të tankeve i rëndonin mbi gjoks; po e mbysnin n'errësirë.*

1 pikë Nëse identifikon një rast ku përshkrimi i qytetit të bombarduar është real.

DHE

1 pikë Nëse identifikon një rast ku përshkrimi i qytetit të bombarduar është i poetizuar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 2 pikë**Përgjigje e plotë**➤ **Nënteksti**

- Nata, ngjyra gri, errësira nuk janë përdorur thjesht si elemente të jashtme, pra koha kur ndodh ngjarja, por si një çast i zymtë i këtij qyteti. Pushtimi sjell errësirë, trishtim, vdekje. Në kontekstin e dhënë nata simbolizon zinë, shkatërrimin, vdekjen, paralizimin e gjithçkaje.
- Ngjyra gri në vetvete është një ngjyrë e ftohtë dhe që shkakton ndjesi mërzie, vetmie, ftohtësie. Në këtë fragment ajo përcjell pikërisht këto ndjesi: ftohtësi, ashpërsi, akullsi. Është kjo pamja që ky qytet i vjetër iu ofron pushtuesve të tij të fundit: ngurtësinë e tij, boshësinë e tij, akullsinë e tij, mungesën e jetës dhe gëzimit.

Përgjigje e pjesshme:

- Shtojnë zymtësinë, trishtimin.
- I japin nuanca më dramatike situatës.

2 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të plotë nëntekstin që japin këto fjalë.

OSE

1 pikë Nëse zbërthen në mënyrë të pjesshme nëntekstin që japin këto fjalë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 24

3 pikë

Përgjigje e plotë

- Po, shumë të fortë. Banorët ndjekin me ankth dhe padurim gjithçka po ndodh. Ata kthehen edhe pse ka rrezik ky kthim. Qyteti është shtëpia e tyre, jeta e tyre dhe ata janë pjesë e tij. Larg tij ata ndihen të huaj, të pafuqishëm, konfuzë. Ndaj kthehen.

Përgjigje e pjesshme

- Është një lidhje e fortë.
- Nuk rrinë dot larg tij; gjithë natën e natës, nuk fjeti njeri; të gjithë rrinin të heshtur përjashta në këmbë.

Ilustrime:

ndiqnin me sy dhe me veshë atë që po ndodhte, tani që gjithçka u qetësua, rrinin të ngrirë si statuja; dikush qante; të gjithë përsërisnin fjalët "sonte"; kishin vendosur të ktheheshin etj.

2 pikë

Nëse argumenton **në mënyrë të plotë** lidhjen midis banorëve dhe qytetit.

OSE**1 pikë**

Nëse argumenton **në mënyrë të pjesshme** lidhjen midis banorëve dhe qytetit.

DHE**1 pikë**

Nëse argumentin e mbështet me ilustrime nga fragmenti.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton nëse është dakord ose jo me pohimin e dhënë;
- mban qartë një pozicion të dukshëm në zgjedhjen e bërë;
- përdor shembuj dhe arsye specifike për të mbështetur përgjigjen e dhënë, duke iu referuar përvojës personale ose edhe përvojave të të tjerëve;
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen;
 - zhvillimin;
 - përfundimin.

Nxënësi merr **1 pikë**, nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla, si: koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme nga njëri paragraf te tjetri).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë;
- shprehet me një gjuhë eseistike;
- ka fjalor të pasur;
- ka stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore;
- ndërton fjali të sakta dhe të qarta;
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm;
- ka saktësi drejtshkrimore.